**DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE BERAT**

# RELACION

***Mbi punimet konservuese dhe restauruese që do të kryen në kullat 11-12, 12-13 dhe kurtina midis tyre, në lagjen "Kala' - Berat***

Berat, 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E KULTURËS - INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE - TIRANË

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT:

1. VENDNDODHJA ........................................................ 3

2. HISTORIKU ........................................................ 4

3. GJENDJA EKZISTUESE ........................................................9

4. PUNIMET RESTAURUESE QË JANË PARASHIKUAR........................................................ 12

Berat, 2023

## RELACION

***Mbi punimet konservuese dhe restauruese që do të kryen në kullat 11-12, 12-13 dhe kurtina midis tyre në lagjen "Kala" – Berat***

## VENDNDODHJA

Kodra e qytetit të fortifikuar të Beratit ka formë të një trikëndëshi të çrregullt të rrethuar me mure që formojnë anët e gjata të lakuara, prej të cilave ajo lindorja arrin deri në 600 m gjatësi, ndërsa ana veriperëndimore dhe jugperëndimore nga 400 m. secila. Kështu muret rrethuese të periudhës qytetare ilire duke iu përshtatur konfiguracionit të terrenit të kodrës arrijnë një gjatësi prej 1400 m. linear.

Këto mure së bashku me sistemin e kullave dhe të galerive që lidhin kështjellën me lumin rrethojnë një sipërfaqe prej 16 ha, nga e cila 10 ha i takojnë territorit të brendshëm të qytetit, ku sot shtrihet një lagje karakteristike me tipare arkitektonike të krijuara në shek.XVIII-XIX dhe disa monumente kulti (shek.XIII-XIV).[1] Kullat 12-13 dhe kurtina midis tyre ndodhen në anën jugore të lagjes Kala.




*Foto 1: Vendndodhja e kullave ne lagjen Kala*

[1] Hëna Spahiu, *Qyteti iliro-arbëror i Beratit*, Tiranë, 1990, f.38

## HISTORIKU

Në këtë gjini ndërtimore siç është fortifikimi, në rrethimin e parë të tij kemi marrë në interesin tonë, kullat 12-13 dhe kurtina midis tyre, për pastrimin nga vegjetacioni i lartë e të ulët, konservimin, restaurimin konsolidimin, mirëmbajtjen e tyre duke marrë masa dhe parandaluar në kohë mbi degradimet e mundshme.

Tek këto kulla dhe kurtina jemi munduar të paraqesim edhe fazat e ndërtimit, ndërhyrjet që ka pësuar ky fragment gjatë shekujve. Është realizuar një hetim sistematik në terren për nxierrjen në pah të tyre duke i paraqitur grafikisht fazat me legjendë.

Faza e I-rë shek.III p.e.s - Muratura e gurit e lidhur në të thatë (pa lidhje llaçi). Pamja e brendshme e murit ilir.
Faza e dytë shek.XIII – Muratura e gurit me përdorimin e blloqeve të gurëve antike duke përdorur edhe tullën, por edhe me teknikë të çrregullt me gurë gëlqerorë të papunuar.
Faza e III-të shek.XVIII-XIX. Ndërtimet e fundit të rëndësishme në fortifikimin e Beratit i takojnë shek.XVIII. Kronika e Kostandin Beratasit bën të ditur vitin 1768 Ahmet Kurt Pasha e rindërtoi fortifikimin, duke vënë për të përpunuar mbi 5 muaj 450 ustallarë, ndërsa Leak bën të ditur për ndërtimet e Ali Pashës dhe…Gjurmët tregojnë se në këtë kohë përshtaten për artileri të paktën 6 kulla dhe 4 mure perde, mbyllen gjoks mburoja e mureve perde në disa vende në të hapen frëngji pushke.[2]
Faza e IV-t – Gjysma e dytë e shek.XX. Mirëmbajtje, konsolidime, restaurime & konservime të kryera nga Ateljeja e Monumenteve të Kulturës në Berat, sot DRKK- Berat.

**DOKUMENTIM FOTOGRAFIK - FOTO TË VJETRA**
**(ARKIVI I IMK-SË, TIRANË)**





Kulla Nr.12 para restaurimit.

[2] A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, *Berati historia dhe arkitektura*, Tiranë, 1988, f.46-47

## DOKUMENTIM FOTOGRAFIK - FOTO TË VJETRA
## (ARKIVI I IMK-SË, TIRANË)






Foto të pjesshme nga kulla Nr.12 deri në 13 dhe kurtina midis tyre.
(Faqja e brendshme e murit)



Foto të përgjithshme e kullave Nr.11, 12 dhe 13 dhe kurtinat midis tyre.
(Faqja e jashtme e mureve)

## (ARKIVI I IMK-SË, TIRANË)






Foto të pjesshme nga kulla Nr.12 deri në 13 dhe kurtina midis tyre. (Faqja e brendshme e murit) - **Para restaurimit.**






Foto të pjesshme nga kulla Nr.12 deri në 13 dhe kurtina midis tyre. (Faqja e brendshme e murit) - **Gjatë restaurimit.**



**Pas restaurimit.**

(ARKIVI I IMK-SË, TIRANË)







**Foto të pjesshme nga kulla Nr.12 deri në 13 dhe kurtina midis tyre. (Faqja e jashtme e murit)**










*Foto 2: Dokumetim fotografik. Foto të vjetra të kullave*

SHPEGUES:

Ndërtime të periudhës bizantine, shek.IX-XII. Muraturë guri e çregullt, me gurë gëlqerorë të papunuar, që për nivelim, lidhje dhe mbajtje nga uljet e çregullta, përshkohet prej breza tullash. Shih Apollon Baçe, *Qyteti i fortifikuar i Beratit*, "Monumentet", 2,1971, Tiranë: Mihal Duri,1971, f.53) TAB I mbi "Të dhëna teknike për ndërtimet me muraturë të përzierë. Muratura e gurit me ripërdorimin e blloqeve të gurëve antike duke përdorur edhe tullën, por edhe me teknikë të çregullt me gurë gëlqeror të papunuar.

Shek.XIV - Ndërtime të periudhës së principatave feudale. Muraturë "e derdhur": midis dy pareteve prej gurësh të vegjël të papunuar dhe copash tjegulle lidhur me llaç gëlqereje. (Shih TAB IV,1, Apollon Baçe, *Qyteti i fortifikuar i Beratit*, "Monumentet", 2,1971, Tiranë: Mihal Duri,1971, f.50)

SHEK.XVIII-XIX - Ndërtimet e fundit të rëndësishme në fortifikimin e Beratit i takojnë shek.XVIII. Kronika e Kostandin Beratasit bën të ditur se në vitin 1768 Ahmet Kurt Pasha e rindërtoi fortifikimin, duke vënë për të punuar mbi 5 muaj 450 ustallarë, ndërsa Leak bën të ditur për ndërtimet e Ali Pashës dhe ... Gjurmët tregojnë se në këtë kohë përshtaten për artileri të paktën 6 kulla dhe 4 mure perde, tabyllen gjoks mbureja e mureve perde në disa vende në të hapen frëngji pushke (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura, Tiranë, 1988, f.46, 47)






ZBËRTHIMI I FAZAVE TË NDËRTIMIT
KULLA NR.11-12 DHE KURTINA MIDIS TYRE (PAMJA E JASHTME JUGORE) SHK.1:100



SHPEGUES:

Shek.XIV - Ndërtime të periudhës së principatave feudale. Muraturë "e derdhur": midis dy pareteve prej gurësh të vegjël të papunuar dhe copash tjegulle lidhur me llaç gëlqereje. (Shih TAB IV,1, Apollon Baçe, *Qyteti i fortifikuar i Beratit*, "Monumentet", 2,1971, Tiranë: Mihal Duri,1971, f.50)

Shek.XIV - [illegible] (Shih TAB IV,1, Apollon Baçe, *Qyteti i fortifikuar i Beratit*, "Monumentet", 2,1971, Tiranë: Mihal Duri,1971, f.51)

SHEK.XVIII-XIX - [illegible] (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura, Tiranë, 1988, f.46, 47)

[illegible] D.R.K.K. - Berat.



ZBËRTHIMI I FAZAVE TË NDËRTIMIT
KULLA NR.12-13 DHE KURTINA MIDIS TYRE (PAMJA E JASHTME JUGORE) SHK.1:100






*Foto 3: Fazat e ndërtimit të kullave*

## GJENDJA EKZISTUESE DHE PROBLEMATIKAT

Gjëndja e kullave 11,12,13 dhe kurtinave midis tyre paraqitet mjaft problematike dhe është e nevojshme të kryhen ndërhyrje të menjëhershme restauruese. Problematike është dëmtimi i kreut të sipërm të murit dhe mungesa e gurëve në kreun e sipërm të murit. Një tjetër problematikë në këto segmente shfaqen dhe zgavrimet dhe vrima të ndryshme në murin e gurit në kurtinat midis kullave në faqet e brëndshme dhe të faqet e jashtme të tyre. Problematike janë dhe dëmtimi i shkallëve që te cojnë te shtegu i kalimit. Gjithashtu problematike shfaqet mbushja me dhera dhe hedhurina të tjera në kullën nr.12 dhe në ambientet e selisë së feudalit. Problematike në këto segmente është prezenca e bimësisë së ulët dhe të lartë në anën e jashtme dhe te brëndshme të kullave dhe kurtinave midis tyre.

**DOKUMENTIM FOTOGRAFIK - GJENDJA EKZISTUESE**
**(Kulla Nr.11-12 dhe kurtina midis tyre: faqja e brendshme & e jashtme e tyre)**


Fig.1


Fig.2

**Problematikat**

**- Bimësi e ulët në kreun e murit - Mbushje dherash, hedhurina te tjera (gure, aliçe etj) dhe bimësi e ulët dhe e lartë brenda kullës Nr.12 dhe në ambjentet e selisë së feudalit - Vrima të madhësive të ndryshme në mure - Zgavrime në faqet e brendshme të mureve.**


Fig.5


Fig.3


Fig.4


Fig.6

## (Kulla Nr.12-13 dhe kurtina midis tyre: faqja e jashtme e murit)
## Problematikat

**- Bimësi e ulët dhe e lartë - Zgavrime në faqet e jashtme të mureve. - Çarje të mureve. - Dëmtime të gjoks-mburojave.**


Fig.1


Fig.2


Fig.3


Fig.4


Fig.5


Fig.6


Fig.7


Fig.8


Fig.9


Fig.10


Fig.11


Fig.12

## DOKUMENTIM FOTOGRAFIK - GJENDJA EKZISTUESE
## (Kurtina midis kullës Nr.12-13 & kulla Nr.13: faqja e brendshme e murit)


Fig.1


Fig.2


Fig.3


Fig.4

## Problematikat

**- Bimësi e ulët mbi shtegun e kalimit dhe në faqen e brendshme të murit - Dëmtime tek shtegu i kalimit dhe në gjoks-mburoja (bedena)- Zgavrime në faqet e brendshme të mureve.**


Fig.5


Fig.6


Fig.7


Fig.8

*Foto 4: Gjëndja ekzistuese dhe problematikat e kullave*

## ***Problematika sipas fotove:***

1.Dëmtimi i kreut të sipërm të murit

2.Zgarvirime dhe vrima të ndryshme në mur

3.Dëmtimi i shkallëve qe të cojnë tek shtegu i kalimit

4.Hedhja e dherave dhe hedhurina të ndryshme në kullën nr.12 dhe në në ambientet e selisë së feudalit

5.Prezencë e vegjetacionin të lartë dhe të ulët

**PUNIMET RESTAURUESE QË DO TË KRYEN:**

Në segmentet në kullat 11-12, 12-13 dhe kurtina midis tyre do të kryen këto punime: konservimi, restaurimi, mirëmbatje dhe pastrimi:

Restaurimi i kullaveNr.11 - Nr.12-Nr.13 dhe kurtinave midis tyre:

a) Riparime në muraturë guri të gjoks-mburojave.

b) Plotësim me muratur guri tek pjesët e zgavruara

c) Ndërtim me mur guri i gjoks-mburojave në pjesët e munguara, duke u bazuar në gjurmët ekzistuese dhe dokumentet arkivore fotografike

d) Thyerje betoni dhe riparim në muratur guri.

e) Restaurim i shkallëve tek shtegu i kalimit.

f) Restaurim në muratur guri në faqen e brendshme të portës jugore, me teknikën shqep-qep dhe vendosje trarësh me seksion katërkëndor prej druri.

g) Restaurim në muratur guri i faqeve të brendshme.

h) Konsolidim i kreut të murit.

i) Çlirim i frëngjisë nga murosja.

*Punime pastrimi:*

Pastrim i vegjetacionit të ulët dhe të lartë.

a) Aplikimi i biocideve perms injeksioneve në kanalet përçuese ose me pompë spërkatëse.

b) Pas tharjes realizohet prerja e rrënjëve të tyre duke përdorur pajisjeje mekanike të cilat nuk shkaktojnë dridhje.

c) Larje të përsëritur e sipërfaqjes me ujë të pastër për të moderuar presionin në mënyrë që të heq të gjitha gjurmët e mbetura të biocideve.

d) Pastrim nga gurët, aliçet, dherat dhe mbeturinat brenda kullave pa ndërhyrë në shtrsat kulturore nëse ka. Ekzistenca e gurëve, aliçeve dhe dherave, janë nga punimet e kryera ndër vite për mirëmbatjen e mureve dhe kullave të kalasë.

e) Transport mbeturinash.


SHPJEGUES:
Punime pastrimi:
Pastrimi i mureve të jashtme dhe terrenit nga bimësia e ulët dhe e lartë.
Punime konservimi & restaurimi:
Riparime në muraturë guri të gjoks-mburojave.
Plotësim me muratur guri tek pjesët e zgavruara.
PROJEKT KONSERVIMI & RESTAURIMI
KULLA NR.12-13 & KURTINA MIDIS TYRE
PAMJA JUGORE (PARAQITJA PJESORE) SHK.1:100
PROJEKT KONSERVIMI & RESTAURIMI
KULLA NR.12-13 & KURTINA MIDIS TYRE
PAMJA JUGORE SHK.1:100




**PROJEKT KONSERVIMI & RESTAURIMI**
**KULLA NR.12-13 & KURTINA MIDIS TYRE**
**PAMJA JUGORE (PARAQITJA PJESORE) SHK.1:100**




**ZBËRTHIMI I FAZAVE TË NDËRTIMIT**
**KULLA NR.10 -11, 11-12 (PARAQITJA E SEGMENTIT PJESORE, FAQJA E BRENDSHME E MURIT) SHK.1:10**



Mendojmë se këto punime pastrimi nga vegjetacioni i lartë e të ulët, punime konservimi, restaurimi, konsolidimi e mirëmbajtje të kullave dhe kurtinave midis tyre do të nxirrnin më shumë në pah vlerat e kësaj gjinie ndërtimore siç është fortifikimi (kalaja) dhe parandalonin në kohë degradimet e thella të mundshme.

Përgatiti:
Ing. Rest. **Eriseld Zyka**

Dhimitraq Niko

Digitally signed by Dhimitraq Niko
Date: 2023.03.21 12:08:06 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE - TIRANË